

"MELAR" SHPK

AKT THEMELIMI

PËR

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 01/11/2024 në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në bazë të kushteve që vijnë;

Themeluesit:

1. Mirgen Dervishi, atësia Gëzim, lindur në Lushnje, më datë 05.12.1985, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, P. 138, H. 1, Ap. 27, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BE3825478, dhe Nr. Personal I51205043G.

NENI 1

Mirgen Dervishi, do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajë: "MELAR" Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

Kryerja e Shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC (Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve). Kryerja e Shërbimeve të kontabilitetit. Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ngritja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemeve. Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale. Përgatitjen e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për palët e treta, rivlerësim aktivitetesh, këshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, këshillime për fillim aktiviteti tregtar etj. Konsulenca fiskale, për njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Shërbime të tjera të lidhura me shoqëritë tregtare, si: ndarje, bashkim, përthithje, administrim, likuidim, falimentim; rritje dhe zvogëlim kapitali; hetime të posaçme, përfaqësim në çështje gjyqësore që kërkojnë një ekspertizë kontabile ose fiskale, tregtare, ekonomike etj. Përfaqësimi i njësive ekonomike si për qëllime tatimore, gjyqësore apo kundrejt palëve të treta. Ofrimi i shërbimeve të mbajtjes së selisë për njësi të tjera ekonomike, etj. Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive shoqërive të përbashkëta apo formave të tjera të lejuara nga legjilacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptar ose të huaj, për të realizuar operacione tregtare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për shoqërinë si dhe për çdo lloj

aktiviteti që do ti shërbeje realizimit të objektit. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

NENI 2

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën : Njësia Administrative Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Zona Kadastrale 8260, Pall. 2, H. 1, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 3

KOHËZGJATJA Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR i shoqërisë është 2,000,000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga "ortakët" e shoqërisë :

- 1- Mirgen Dervishi, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 2,000,000 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 2,000,000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 5

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Mirgen Dervishi, atësia Gëzim, lindur në Lushnje, më datë 05.12.1985, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 7, Bulevardi Gjergj Fishta, P. 138, H. 1, Ap. 27, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BE3825478, dhe Nr. Personal I51205043G, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.



NENI 6

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me regjistrim në “Qendrën Kombëtare të Biznesit” në bazë të Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“MELAR” SHPK

MIRGEN DERVISHI

Mirgen Dervishi

